

Hapet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit Metropolitan Tirana, në Universitetin e Barit “Aldo Moro” në Itali, në kuadër të Projektit COMMO VII i koordinuar nga UNIMED dhe i financuar nga Programi Erasmus +, për semestrin e parë/dytë të vitit akademik 2024-2025.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e parë/dytë të vitit akademik 2024-2025 në Universitetin e Barit “Aldo Moro” në Itali.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2023 -2024 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë, të ciklit bachelor si edhe studentët e vitit të parë dhe të dytë master, në fakultetin dhe programet:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
- Fakulteti i Ekonomisë

Lëndët të cilat zhvillohen në anglisht në universitetin pritës në semestrin e parë i gjeni duke klikuar në linkun: <https://www.uniba.it/en/education>

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).
Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni: http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës;
- Certifikatë ose vetëcertifikim që vërteton njohuritë e gjuhës angleze dhe/ose italiane në varësi të destinacionit (niveli minimal B2);
- Curriculum Vitae (maksimumi 4 faqe);
- Formulari i aplikimit për çdo [loj mobiliteti](#);
- Listë notash;
- Vërtetim Studenti.

Përzgjedhja e studentëve për qëllime studimi (SMS) do të respektojë kriteret e mëposhtme:

- Nota mesatare (30 pikë);
- Numri i krediteve të marra në raport me vitin aktual (30 pikë);
- Njohuri të gjuhës angleze (40 pikë).

Afati për aplikim: 29 Shkurt, 2024

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!